



Република Северна Македонија  
ВРХОВЕН СУД  
НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
ПРЕТСЕДАТЕЛ

Republika e Maqedonisë së Veriut  
GJYKATA SUPREME  
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT  
KRYETARI

---

Бул.“Крсте Мисирков” бр.8, 1000 Скопје; тел.02/3164-064; [info@vsrm.mk](mailto:info@vsrm.mk)  
Bul.Krste Misirkov nr.8, 1000 Shkup; tel. 02/3164-064; [info@vsrm.mk](mailto:info@vsrm.mk)

---

**03Su Nr. 264 / 2020**

**18.03.2020**

**S h k u p**

**Deri në**

**Shoqatën e produksionit audio dhe video**

**360 gradë DOO Shkup**

**Lënda: Reaksion dhe kërkesë për publikim të demantit**

Në lidhje me tekstin e publikuar me titull “Gjendje e jashtëzakonshme në Gjykatën supreme: Motra e gjyqtares e infektuar nga virusi korona” më 18.03.2020 në “[www.360stepeni.mk](http://www.360stepeni.mk)”, në kushte të gjendjes së jashtëzakonshme në shtetin që ballafaqohet me krizë serioze është papërgjegjësi dhe e pa arsyeshme që të jepen informacione të pakontrolluara në përgjithësi edhe për Gjykatën më të lartë të shtetit, veçanërisht kur ka të bëjë me informacione të interesit më të gjerë publik ngase e njëjta nuk sjell informacion të vërtetë, të drejtë dhe të gjithanshëm të qytetarëve.

Për këto arsye për informacion të përgjegjshëm dhe të plotë të publikut, ngase në tekstin përfshihen informacione të caktuara të pakonfirmuara që shkaktojnë hutime JU TREGOJ se bëhet fjalë për një çift të martuar – motra dhe dhëndri të gjyqtarit të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, por që nuk janë çifti i martuar që kanë ardhur nga Bulgaria, të njëjtët nuk kanë ardhur nga shtete të jashtme të cilët edhe pse kanë pasur simptome së të ftohurit nuk kanë qenë të testuar për virusin korona dhe testi i tillë u është bërë më 17.03.2020 kur është konstatuar se janë pozitiv. Gjyqtari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut kontaktin e fundit me motrën e tij e ka pasur më 06.03.2020, kur te ata nuk ka pasur simptome të sëmundjes. Duke qenë se nga kontakti i fundit të gjyqtarit të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut deri më sot kanë kaluar 12 ditë dhe se i njëjti nuk ka kurrfarë simptome, megjithatë gjyqtari do të qëndrojë në vetë izolim deri në fund të javës. Njëkohësisht, Ju njoftojmë se

gjyqtari është në komunikim me Qendrën e shëndetit publik dhe i janë përgjigjur se nuk nevojitet ti nënshtrohet testimit.

Kërkojmë që ky demant të publikohet dhe për atë të jemi të njoftuar, e tërë kjo me qëllim për respektimin e të drejtës së publikut për tu informuar në mënyrë adekuate.

**UD KRYETAR  
I GJYKATËS SUPREME  
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT  
M-r Faik Arslani**